



PERCEPTIMET E KOMUNITETIT MBI EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM DHE RIATDHESIMIN E QYTETARËVE TË KOSOVËS NGA FUSHËBETEJAT E ISIS-IT



Autor: Skender Perteshi & Shpat Balaj

Rishikimi i jashtëm: Garentina Kraja

Versioni origjinal i këtij raporti është shkruar në gjuhën angleze

© Të gjitha të drejtat i rezervon Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Ndërlidhura mbron të drejtat dhe pronësinë intelektuale. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem mbajtës ose të transmetohet, në çfarëdo forme a me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik a tjetër, pa lejen me shkrim nga botuesi. Përdorimi komercial i të gjitha mediave të publikuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) nuk lejohet pa miratimin me shkrim të QKSS. Ju lutemi kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Vështrimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informacionit të mbledhur nga aktivitetet në terren të QKSS dhe të anketuarit e sondazhit "Barometri i Sigurisë së Kosovës"¹. Gjetjet tregojnë se si qytetarët perceptojnë ose informohen për çështjet e paraqitura në këtë raport. Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë detyrimisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë ose të Ambasadës së Mbretërisë së Holandës në Kosovë.

Ky projekt mbështetet nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë.



Kingdom of the Netherlands

¹ Barometri i Sigurisë së Kosovës është program brenda QKSS-së që mat mendimin e qytetarëve për çështje të ndryshme të lidhura me sigurinë. Programi mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED). Rezultatet që dalin nga programi, të paraqitura në këtë raport, janë thjesht interpretime të rezultateve të opinionit publik dhe kurrsesi nuk përfaqësojnë pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED)

PERCEPTIMET E KOMUNITETIT MBI EKSTREMIZMIN E DHUNSHËM DHE RIATDHESIMIN E QYTETARËVE TË KOSOVËS NGA FUSHËBETEJAT E ISIS-IT

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME.	1
PERCEPTIMET E QYTETARËVE NDAJ KËRCËNIMEVE TË DHUNSHME EKSTREMISTE KUNDREJT KOSOVËS.	2
PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR RIATDHESIMIN, REHABILITIMIN DHE REINTEGRIMIN E QYTETARËVE TË KOSOVËS NGA FUSHËBETEJAT E KONTROLLUARA NGA IS.	4
PERCEPTIMET MBI PROGRAMET E REINTEGRIMIT DHE REHABILITIMIT.	4
PERCEPTIMET MBI TË KTHYERIT.	7
PERCEPTIMET MBI FËMIJËT E KTHYER.	9
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.	11

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky raport ofron një përmbledhje të perceptimeve të qytetarëve të Kosovës mbi ekstremizmin e dhunshëm. Raporti përqendrohet veçmas në pikëpamjet e tyre mbi riatdhesimin e qytetarëve të Kosovës nga fushëbetejat e Shtetit Islamik në Siri dhe Irak, si dhe perceptimin e qytetarëve mbi përpjekjet e institucioneve dhe OShC-ve në lidhje me riintegrimin dhe rehabilitimin e të kthyerve dhe familjeve të tyre. Raporti, me paraqitje të analizave cilësore dhe sasiore, ofron të dhëna të dorës së parë, të mbledhura në terren përmes hulumtimeve të gjera të QKSS. Të dhënat kryesore që formësojnë aspektin cilësor të raportit rrjedhin nga diskutimet me komunitetet lokale në tetë komuna të Kosovës, të organizuara nga QKSS në kuadër të projektit Ndërtimi i Qëndrueshmërisë: Komunitetet kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Nga ana tjetër, rezultatet sasiore rrjedhin nga Barometri Kosovari i Sigurisë së Kosovës (BKS), program i QKSS që mat opinionin publik për çështje të ndryshme të lidhura me sigurinë.

Rreth 403 qytetarë të Kosovës janë bashkuar me Shtetin Islamik dhe organizatat e tjera terroriste që të krijojnë "Kalifatin Islamik" në Siri dhe Irak. Që nga viti 2012, rreth 250 qytetar të Kosovës janë kthyer ose riatdhesuar nga zonat e konfliktit dhe aktualisht po kalojnë nëpër programe rehabilitimi dhe risocializimi, të implementuara nga institucionet e Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile. Ky raport u frymëzua nga hulumtimet e fundit shkencore mbi riintegrimin dhe rehabilitimin e luftëtarëve të huaj dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të lidhur me Shtetin Islamik dhe organizatat e ngjashme terroriste, të cilat pohojnë se familjet e të kthyerve dhe komuniteti në përgjithësi janë thelbësore për rehabilitimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit.¹ Përmes këtij raporti, QKSS synon ta testojë këtë hipotezë duke hulumtuar përgjigjen e komunitetit ndaj luftëtarëve të huaj dhe familjeve të tyre në Kosovë. Të dhënat tona të mbledhura në gjithë Kosovën, si në zonat e prekura nga ekstremizmi i dhunshëm ashtu edhe në ato të paprekura, tregojnë se publiku ngurron dhe i reziston kthimit të ish-luftëtarëve terroristë (ILT) në mesin e vet, por është dukshëm më i hapur për të pranuar gratë dhe fëmijët e riatdhesuar në komunitetin përkatës. Përkundër themelimit së programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit në Kosovë, qytetarët e Kosovës mbeten skeptikë rreth kapaciteteve të institucioneve për të zbatuar programe të tilla me sukses, duke dëmtuar potencialisht çdo përpjekje institucionale që synon adresimin e kësaj dobësie. Siç argumenton ky raport, qytetarët e Kosovës mbeten kryesisht të painformuar dhe të pasigurt në lidhje me përpjekjet e vazhdueshme për të adresuar ekstremizmin e dhunshëm dhe pasojat e tij në Kosovë. Për më tej, ky raport riafirmon faktin se transparenca dhe komunikimi rreth programeve të riintegritimit mbeten elemente kyçe për të ndryshuar qëndrimin e përgjithshëm të shoqërisë Kosovare karshi të kthyerve. Në përgjithësi, ky raport tregon se qytetarët e Kosovës mbeten vigjilentë dhe i perceptojnë llojet e ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm si kërcënim të vazhdueshëm për sigurinë kombëtare të vendit.


¹ Këshilli i Sigurimit, OKB. (2020). Repatriating Detained Foreign Fighters, Their Families Key to Combating Threat Posed by Islamic State, Counter-Terrorism Officials Warn Security Council. Në dispozicion në: <https://www.un.org/press/en/2020/sc14282.doc.htm>

PERCEPTIMET E QYTETARËVE NDAJ KËRCËNIMEVE TË DHUNSHME EKSTREMISTE KUNDREJT KOSOVËS

Siguria e Ballkanit Perëndimor sfidohet nga forma të ndryshme të ekstremizmit. Të nxitura nga ndikimi keqdashës i fuqive jodemokratike dhe të mundësuar nga partitë politike lokale, politikanët dhe subjektet e ndryshme fetare e politike, në rajon janë shfaqur disa forma të ekstremizmit. Në vitet e fundit, rajoni është bërë një vatër e ekstremizmit etnik, fetar dhe politik, të cilat kanë shfrytëzuar dhe thelluar ndasitë ekzistuese, duke e ndarë më tej rajonin tashmë të dëmtuar nga luftërat e viteve 1990. Përveç kësaj, ekstremizmi i krahut të djathtë dhe nacionalizmi etno-fetar i rajonit, i gjetur kryesisht midis grupeve radikale serbe të lidhura me kriminelët e luftës së viteve 1990, ka filluar të marrë formë dhe të shërbejë globalisht si frymëzim për lëvizjet ekstremiste anti-imigrante të prirura për konspiracion, të tilla si rasti i sulmit terrorist në dy xhami në Christchurch të Zelandës së Re.² Përmes implementimit dhe participimit në aktivitete e diskutime në nivelin lokal dhe përmes matjes së opinionit publik përmes anketës së BKS, QKSS u përpoq të vlerësonte nëse qytetarët e Kosovës i perceptonin këto forma të ekstremizmit si kërcënim për sigurinë kombëtare.

Të anketuarit nga Kosova dukeshin kryesisht të shqetësuar mbi manifestimet e ndryshme të dhunës politike. Sipas 38 përqind të të anketuarve në të gjithë Kosovën, dhuna politike - e përkufizuar si dhunë midis aktorëve politikë dhe mbështetësve të tyre besnikë dhe si nënprodukt i tensioneve të rritura politike dhe i polarizimit - mbetet kërcënimi më i madh për sigurinë e vendit, i ndjekur nga ekstremizmi me bazë etnike. 20 përqind e të anketuarve e renditën ekstremizmin e krahut të djathtë si kërcënimin e tretë. Shqetësimi në rritje mbi ekstremizmin e krahut të djathtë - i cili ende nuk është shprehur në Kosovë - mund të jetë reflektim i rritjes së konsiderueshme të kësaj forme të ekstremizmit në Evropë dhe në vendet fqinje në vitet e fundit. Sidoqoftë, 30 përqind e të anketuarve nuk kanë asnjë mendim lidhur me kërcënimet që dalin nga ekstremizmi i krahut të djathtë, duke treguar se një pjesë e madhe e qytetarëve nuk ka njohuri për këtë formë të ekstremizmit. Në anën tjetër, dhuna/ekstremizmi me bazë fetare perceptohet si më pak kërcënues, me 55 përqind të të anketuarve që pohojnë se ky lloj ekstremizmi nuk është kërcënim për sigurinë kombëtare, ndërsa pjesa tjetër ndajnë perceptimin se ky lloj i dhunës është kërcënim i lartë ose deri diku kërcënim.

FIGURA 1 PERCEPTIMI I QYTETARËVE MBI KËRCËNIMET QË I PARAQITEN KOSOVËS NGA FORMA TË NDRYSHME TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM



2 BBC (2019). Christchurch shootings: 49 dead in New Zealand mosque attacks. Në dispozicion në: <https://www.bbc.com/news/world-asia-47578798>

Qëndrime të ngjashme u demonstuan edhe nga pjesëmarrësit në diskutimet e QKSS në nivelin komunitar/lokal. Pjesëmarrësit e diskutimeve theksuan se ekstremizmi me bazë etnike theksohet deri në njëfarë mase në Kosovë, kryesisht për shkak të konflikteve midis serbëve dhe shqiptarëve në të kaluarën. Siç argumentohet nga pjesëmarrësit, për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin me bazë etnike, duhet të trajtohen sfidat e pazgjidhura nga konfliktet e kaluara dhe të ketë promovim më të gjerë të marrëdhënieve ndëretnike, bazuar në reflektimin e të kaluarës.³


³ Diskutim publik me komunitetet lokale, institucionet lokale dhe OShC-të lokale. Mitrovicë, 14 maj 2020.

PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR RIATDHESIMIN, REHABILITIMIN DHE RI-INTEGRIMIN E QYTETARËVE TË KOSOVËS TË KTHYER NGA ZONAT E KONFLIKTIT

PERCEPTIMET MBI PROGRAMET E RI-INTEGRIMIT DHE REHABILITIMIT

Më se 250 qytetarë të Kosovës janë riatdhësuar nga Siria dhe Iraku dhe iu nënshtruan ose po u nënshtrohen programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit, si dhe iniciativave të ndërmarra nga institucionet e Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile. Sidoqoftë, qytetarët nuk kanë informacion të mjaftueshëm se çfarë konkretisht po punohet në përpjekjet për rehabilitim dhe ri-integrim. Përveç mungesës së informacionit të komunitetëve lokale, institucionet dhe OShC-të lokale janë shumë pak ose nuk janë fare të përfshira në këto procese, për shkak të kapaciteteve të kufizuara operacionale dhe financiare për të zbatuar projekte dhe aktivitete të kësaj natyre.⁴ Megjithatë niveli lokal konsideron se ka njohuritë e nevojshme për të kontribuar në këto procese, deri më tani, niveli qendror nuk ka paraparë rolin dhe nuk ka përdorë potencialin e tyre në këtë drejtim.⁵ Kjo shihet me shqetësim nga komunitetëve lokale pasi ato do të jenë adresa përfundimtare e të kthyerve dhe procesi i ri-integrimit mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse vetë komunitetëve forcohen dhe angazhohen.⁶ Në këtë drejtim, përmes BKS, QKSS analizozi se sa janë të informuar qytetarët dhe komunitetëve për këto programe. Të dhënat e mbledhura tregojnë se shumica dërrmuese - 75 përqind e të anketuarve - nuk kanë ndonjë informacion në lidhje me programet e rehabilitimit dhe ri-integrimit, nëntë përqind kanë informacion të kufizuar dhe vetëm gjashtë përqind kanë deklaruar se janë të informuar mbi këto programe.

FIGURA 2 SA JANË TË INFORMUAR QYTETARËT PËR PROGRAMET E RI-INTEGRIMIT DHE REHABILITIMIT NË KOSOVË



Për më shumë, një aspekt tjetër i rëndësishëm i theksuar nga përfaqësuesit e komunitetit është mos-komunikimi i institucioneve lokale dhe qendrore me komunitetëve lokale dhe OShC-të lokale në lidhje me iniciativat e rehabilitimit dhe ri-integrimit.⁷ Shmangia e bashkëpunimit midis institucioneve lokale dhe qendrore me komunitetëve lokale dhe OShC-të mund ta kufizojë ndikimin e proceseve të rehabilitimit dhe ri-integrimit dhe potencialisht të krijojë pakënaqësi brenda komunitetit, nëse shpërfillen shqetësimet dhe perspektivat e tyre në këto procese.⁸

Pyetja të 'Figura 2' u pasua nga një pyetje e hapur, e cila u lejoi të anketuarve të specifikonin

⁴ Diskutim publik me komunitetëve lokale, institucionet lokale dhe OShC-të lokale. Gjilan, 10 prill 2020

⁵ Po aty

⁶ Diskutim publik me komunitetëve lokale, institucionet lokale dhe OShC-të lokale. Mitrovicë, 14 maj 2020.


⁷ Diskutim publik me komunitetëve lokale, institucionet lokale dhe OShC-të lokale. Prishtinë, 8 gusht 2020,

⁸ Po aty

se çfarë informacioni kanë në lidhje me programet e rehabilitimit dhe ri-integrimit. Përgjigjet janë regjistruar, koduar në kategori dhe analizuar më tej. Bazuar në këto përgjigje, vërehet një boshllëk i njohurive edhe midis atyre që pohuan se kanë njohuri mbi programet e rehabilitimit dhe ri-integrimit. Pothuajse asnjëri nga të anketuarit nuk mund të identifikonte ndonjë program ose aktivitet specifik, të zbatuar nga institucionet ose organizatat lokale e ndërkombëtare. Të anketuarit kryesisht iu referuan akomodimit të përkohshëm të të kthyerve nga zonat e konfliktit në 72 orët e para të kthimit në Kosovë. Këto njohuri m e gjasë dalin si rezultat i mbulimit më të madh mediatik në ditët e para të riatdhesimit të qytetarëve të Kosovës nga Siria dhe Iraku. Nëntëmbëdhjetë përqind e të anketuarve që deklaruan se kanë informacion për programet e ri-integrimit dhe rehabilitimit, deklaruan se kanë njohuri për pjesëmarrjen e të kthyerve në aktivitete të ndryshme, ndërsa 16 përqind thanë se e dinë që institucionet e vendit kanë krijuar disa programe. Në të dyja rastet, të intervistuarit nuk ishin në gjendje të identifikonin specifikisht ndonjë aktivitet ose program të ndërmarrë për individët e riatdhesuar.


Kategoria 'Tjetër' përfshin përgjigje që nuk lidheshin me këtë pyetje specifike, por për shkak të mungesës së informacionit, të anketuarit u përpoqën të siguronin përgjigje konkrete, ndonëse nuk ishin relevante për pyetjen. Në anën tjetër, 9 përqind e të anketuarve ishin të informuar vetëm për riatdhesimin e organizuar të qytetarëve të Kosovës nga Siria në periudhën prill - maj 2019.

FIGURA 3 PYETJE E HAPUR - NËSE KENI INFORMACION MBI PROGRAMET E REHABILITIMIT DHE RI-INTEGRIMIT, ÇFARË INFORMACIONI KENI NË VEÇANTI?




Të anketuarit shprehën dyshim mbi kapacitetet institucionale të Kosovës për t'i ri-integruar të kthyerit në mënyrë efektive. Rreth 30 përqind e të anketuarve ishin skeptikë se institucionet e Kosovës kanë kapacitete për të ri-integruar dhe rehabilituar në mënyrë efektive të kthyerit, ndërsa 26 përqind e tyre besojnë se kapacitetet për ri-integrim janë efektive vetëm në njëfarë mase. Vetëm 29 përqind e të anketuarve besojnë se institucionet e Kosovës kanë kapacitetet e nevojshme për t'i ri-integruar siç duhet të kthyerit.

FIGURA 4 PERCEPTIMI I QYTETARËVE MBI KAPACITETET E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS PËR RI-INTEGRIMIN E TË KTHYERVE



Duke pasur parasysh rëndësinë e koordinimit ndërmjet palëve të ndryshme të interesit dhe punën e institucioneve për rehabilitim dhe ri-integrim, QKSS vlerësoi edhe nëse qytetarët besojnë se institucionet dhe organizatat ndërkombëtare duhet t'i mbështesin të kthyerit me projekte zhvillimore. Në këtë drejtim, qytetarët u shprehën pozitiv, me 77 përqind të të anketuarve që pohuan se institucionet dhe organizatat ndërkombëtare duhet të zbatojnë projekte zhvillimi për t'i mbështetur të kthyerit. Për më tej, komunitetet lokale besojnë se është e rëndësishme të mbështeten edhe OShC-të lokale, në mënyrë që ato të mund të zhvillojnë dhe të zbatojnë aktivitete që do t'i plotësojnë përpjekjet e rehabilitimit dhe ri-integrimit të nivelit qendror.⁹ Sipas akterëve lokalë, iniciativat lokale si p.sh. "Fol Tash"¹⁰ në qytetin e Podujevës, kanë kontribuar në deradikalizim, duke e rritur vetëdijesimin kundër ekstremizmit të dhunshëm, ndërsa reflektimi i nismave të tilla në procesin e ri-integrimit do të kontribuonte në efektivitetin më të madh të procesit.

FIGURA 5 PERCEPTIMI I QYTETARËVE NËSE INSTITUCIONET VENDORE DHE ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DUHET TË PËRKRAHIN TË KTHYERIT ME PROJEKTE ZHVILLIMORE




9 Diskutim publik me komunitetet lokale, institucionet lokale dhe OShC-të lokale. Podujevë, 8 maj 2020.

10 Për më shumë informacion mbi platformën, ju lutem shikoni: <https://www.foltash.com/>

PERCEPTIMET MBI TË KTHYERIT

Publiku kosovar i percepton të kthyerit si kërcënim për sigurinë. 51 përqind e të anketuarve në Barometrin Kosovar të Sigurisë besojnë që të kthyerit janë kërcënim ose kërcënim i lartë për Kosovën, ndërsa 41 përqind e tyre besojnë se ata paraqesin kërcënim shumë të vogël ose aspak kërcënim. Një perceptim i tillë u vërejt gjithashtu në diskutimet lokale të QKSS-së, ku shumë pjesëmarrës shprehën shqetësime për individë të caktuar që janë kthyer nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Skepticizmi dhe frika e tyre ndaj këtyre individëve po rrit potencialin për stigmatizim të individëve të caktuar, duke theksuar nevojën për të rritur vetëdijesimin në komunitet rreth qasjes së komunitetit ndaj të kthyerve.¹¹



Kjo pyetje u pasua nga një pyetje e hapur për të kontekstualizuar mendimin e shumicës së të anketuarve. 40 përqind e të anketuarve besojnë se të kthyerit ende kanë ideologji ekstremiste, e cila paraqet rrezik për sigurinë e Kosovës, ndërsa 30 përqind e mbajnë mendimin se të kthyerit janë mësuar në një mjedis të dhunshëm dhe si të tillë mund të shkaktojnë dhunë edhe në Kosovë. 16 përqind e të anketuarve që besojnë se të kthyerit janë një kërcënim për Kosovën, mendojnë se të kthyerit mund të ndikojnë negativisht tek të tjerët. Nga ana tjetër, kategoria 'Tjetër' përmbledh përgjigjet më të rralla që kanë të bëjnë me përhapjen e mundshme të sëmundjeve të ndryshme nga të kthyerit, mungesën e kapacitetit shtetëror për rehabilitimin ose kontrollimin e tyre, ndjenjat e përgjithshme të pasigurisë ndaj tyre ose besimin e të anketuarve se nuk duhej të ishin riatdhesuar fare.




Për më shumë, QKSS ka analizuar gatishmërinë e qytetarëve për t'i pranuar të kthyerit në komunitetet e tyre përkatëse. Të anketuarit në përgjithësi hezitojnë t'i pranojnë ata: 39 përqind e të anketuarve thanë se nuk do t'i pranonin burrat e kthyer në komunitet, ndërsa 38 përqind e mbajnë këtë perceptim për gratë e kthyerat. Për më tepër, 44 përqind e të anketuarve thanë

¹¹ Për më shumë informacion mbi platformën, ju lutem shikoni: <https://www.foltash.com/>


se do t'i pranonin të kthyerit burra e gra, por me kusht që të ishin nën mbikëqyrje të ngushtë nga institucionet. Rritja e ndjenjës së sigurisë së qytetarëve kur mbështeten në institucione, riafirmon rëndësinë e përfshirjes së institucioneve të nivelit lokal në procesin e ri-integrimit dhe rehabilitimit, si kontakti i parë institucional i qytetarëve. Për më tej, institucionet lokale duhet të jenë më të angazhuara dhe më të zëshme në aspektet sociale dhe ekonomike të qytetarëve të tyre dhe t'i rrisin përpjekjet në ndërtimin e kohezionit social midis komuniteteve në Kosovë. Kështu, institucionet do të siguronin qëndrueshmërinë e komunitetit, rrjedhimisht duke i bërë komunitetet më të pacenueshme, të sigurta e të qëndrueshme, si dhe më të hapura për personat e riatdhesuar.¹²

FIGURA 8 A JANË TË GATSHËM QYTETARËT T'I PRANOJNË TË KTHYERIT NË KOMUNITETET E TYRE PËRKATËSE?



Kur u pyetën nëse Kosova duhet t'u japë grave të kthyerja një shans për t'u integruar në Kosovë, të anketuarit u përgjigjën më pozitivisht. Vetëm 15 përqind e të anketuarve besojnë se nuk duhet t'u jepet fare shans, ndërsa 35 përqind mbajnë mendimin se duhet t'u jepet shans. Ndërkohë, 45 përqind e të anketuarve besojnë se duhet t'u jepet një shans, por me mbikëqyrje të ngushtë nga institucionet.

FIGURA 9 PERCEPTIMI I QYTETARËVE NËSE GRAVE TË KTHYERA DUHET T'U JEPET NJË SHANS TJETËR PËR TË JETUAR NË KOSOVË




¹² Diskutim publik me komunitetet lokale, institucionet lokale dhe OShC-të lokale. Fushë Kosovë, 7 korrik 2020.

PERCEPTIMET MBI FËMIJËT E KTHYER

Njëra nga sfidat kryesore të institucioneve mbetet ri-integrimi dhe rehabilitimi i fëmijëve të kthyer. Fëmijët që udhëtuan me familjet e tyre në zonat e luftës dhe ata që lindën atje gjatë konfliktit, janë potencialisht të prekur nga trauma dhe i nënshtrohen izolimit dhe stigmatizimit nga shoqëria. Ndonëse njëri nga elementet kryesore në përpjekjet e suksesshme të ri-integrimit është shoqërimi me fëmijët e tjerë dhe komunitetin në përgjithësi, fëmijët e riatdhesuar në Kosovë kalojnë shumicën e kohës me fëmijët e tjerë të riatdhesuar dhe anëtarët e familjes së ngushtë.¹³ Prandaj, njëra nga çështjet kryesore të vlerësuara nga QKSS ishte gatishmëria e qytetarëve të Kosovës për t'i lejuar fëmijët e vet të shoqëroheshin me fëmijët e riatdhesuar. Rezultatet janë shqetësuese dhe tregojnë potencial për stigmatizimin e fëmijëve të kthyer dhe izolimin e mëtejshëm. 55 përqind e të anketuarve thanë se nuk do të lejonin që fëmijët e tyre të shoqëroheshin me fëmijët e riatdhesuar nga zonat e konfliktit, ndërsa 32 përqind e tyre nuk kanë ndonjë problem me këtë.

FIGURA 10 GATISHMËRIA E QYTETARËVE PËR TË LEJUAR FËMIJËT E TYRE TË SHOQËROHEN ME FËMIJËT E KTHYER




Kjo pyetje u pasua nga një pyetje e hapur, në të cilën të anketuarve iu dha shansi për të elaboruar pse kanë pikëpamje të tilla. 56 përqind e të anketuarve besojnë se për shkak të përvojave të fëmijëve të kthyer në zonat e luftës, si dhe ekspozimit të tyre ndaj ideologjive ekstreme, ata mund të kenë ndikim negativ tek fëmijët e tyre nëse do të lejohen të shoqërohen me ta. 18 përqind e të anketuarve kanë një frikë të përgjithshme dhe ndjenjë pasigurie nga fëmijët e kthyer, por nuk kanë arsye tjetër specifike pse ta parandalojnë shoqërimin e fëmijëve të vet me ta. 12 përqind e të anketuarve janë të mendimit se fëmijët e kthyer janë kërcënim i mundshëm i sigurisë dhe prandaj nuk do të ndiheshin rehat që t'i lejonin fëmijët e vet të shoqërohen me ta. Vetëm dy përqind e të anketuarve deklaruan se në parim do t'i lejonin fëmijët e tyre të shoqëroheshin me të fëmijët e kthyer, megjithatë vetëm pasi të siguroheshin se janë rehabilituar dhe janë nën mbikëqyrjen e shtetit. Kategoria 'Tjetër' paraqet përgjigje të ndryshme që nuk ishin aq të shpeshta dhe kryesisht përbëhet nga përgjigje që thjesht konfirmuan se ata nuk do të lejonin që fëmijët e vet të shoqëroheshin me të kthyerit, pa dhënë arsye konkrete. Qasje e ngjashme u vu re në diskutimet me komunitetet lokale të organizuara nga QKSS në tetë komuna të Kosovës për nevojat e mbledhjes së të dhënave për këtë raport. Pjesëmarrësit theksuan shqetësimet e tyre ndaj fëmijëve të riatdhesuar dhe vunë në dukje se do të hezitonin t'i linin fëmijët e vet të shoqëroheshin me ta. Arsyet prapa këtyre qëndrimeve lidhen kryesisht me frikën e komunitetit se fëmijët e riatdhesuar janë potencialisht më të prirur ndaj radikalizmit dhe mund të përhapin ideologji ekstremiste.¹⁴

13 Observim i ekipit të QKSS përmes pjesëmarrjes në aktivitetet dhe programet për ri-integrimin dhe rehabilitimin e fëmijëve të kthyer.


14 Diskutim publik me komunitetet lokale, institucionet lokale dhe OShC-të lokale. Gjilan, 10 prill 2020.

FIGURA 11 PYETJE E HAPUR - NËSE NUK JENI TË GATSHËM TË LEJONI QË FËMIJËT TUAJ TË SHOQËROHEN ME FËMIJËT E KTHYER, PSE?



Të anketuarit shprehën qëndrime më pozitive, kur u kërkua të japin mendimin nëse besojnë se fëmijët e kthyer duhet të integrohen në sistemin e rregullt arsimor me moshatarët e tyre. 35 përqind e të anketuarve deklaruan se fëmijët e kthyer duhet të integrohen në sistemin arsimor me bashkëmoshatarët, kurse 45 përqind e tyre mbajnë të njëjtin mendim, por me kusht që fëmijët e kthyer të vendosen nën mbikëqyrje të ngushtë nga institucionet, ndërsa ndjekin shkollën me të tjerët. 15 përqind e të anketuarve besojnë se ata nuk duhet të integrohen në sistemin e rregullt arsimor.

FIGURA 12 MENDIMI I QYTETARËVE NËSE FËMIJËT E KTHYER DUHET TË INTEGROHEN NË SISTEMIN E RREGULLT ARSIMOR ME MOSHATARËT



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Programet e rehabilitimit dhe ri-integrimit për personat e riatdhesuar nga zonat e konfliktit duhet të hartohen duke u bazuar në nevojat individuale të atyre të cilëve do t'u drejtohen programet përkatëse. Institucionet dhe OShC-të duhet të zbatojnë një qasje proaktive për përfshirjen e komunitetit në zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe ri-integrimit, duke pasur parasysh faktin se komuniteti është i rezervuar në pranimin e të kthyerve në komunitetet e veta.

Institucionet e Kosovës kanë centralizuar komunikimin ndërmjet institucioneve të ndryshme, OShC-ve dhe komunitetit me të kthyerit, përmes Divizionit për Parandalimin dhe Reintegrimit e Personave të Radikalizuar brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme. Rrjedhimisht, në rast se aktorë të caktuar kanë interes dhe kapacitete për të zbatuar projekte ose aktivitete në shërbim të ri-integrimit dhe rehabilitimit, kontributi i tyre gjithmonë kanalizohet përmes këtij mekanizmi. Për shkak të procedurave burokratike dhe barrës së një mekanizmi të vetëm që shërben si lidhje midis aktorëve të ndryshëm dhe të kthyerve, dhe kontaktit të vazhdueshëm të të kthyerve me një institucion të vetëm, potencialisht ngadalëson socializimin e tyre, i cili është element kryesor për ri-integrimin e plotë në shoqëri.

Më shumë vëmendje duhet t'u kushtohet fëmijëve të kthyer që, bazuar në kërkimet dhe aktivitetet tona, janë më të prirur për stigmatizim, pasi bashkëndajnë një ndjenjë izolimi dhe diskriminimi nga komuniteti. Ndonëse integrimi i tyre në sistemin shkollor ka përparuar dukshëm, shumica vazhdojnë t'i ndjekin mësimet në klasa speciale, ndaras nga fëmijët e tjerë. Kështu, ata kanë hapësirë të kufizuar për t'u shoqëruar me fëmijë të tjerë, jashtë rrethit të të kthyerve, çka pengon deri diku integrimin e tyre shoqëror. Kjo ndikon edhe në perspektivën e gatishmërisë së komunitetit për të pranuar fëmijët e kthyer, duke pasur parasysh se një pjesë e madhe e qytetarëve nuk ndihen të sigurt për t'i lejuar fëmijët e vet të shoqërohen me fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit.

Nga ana tjetër, gratë dhe burrat e kthyer, midis sfidave të tjera, po përballen me pengesa të mëdha për punësim në sektorin publik dhe privat në Kosovë. Ndonëse punësimi i tyre në sektorin publik pengohet në njëfarë mase nga përgjegjësia penale që mbajnë për kohën e kaluar në zonat e konfliktit, sektori privat po refuzon t'i punësojë pasi vazhdon t'i perceptojë si një kërcënim për kompanitë dhe komunitetin në përgjithësi.

Në mënyrë që procesi i ri-integrimit dhe rehabilitimit të jetë sa më efektiv dhe të adresojë mangësitë e identifikuara në këtë raport, QKSS ofron rekomandimet e mëposhtme:

1. Procesi i komunikimit dhe punës me individë të riatdhesuar duhet të lehtësohet më tej dhe jo detyrimisht të përqendrohet në një mekanizëm të vetëm, siç është rasti me Divizionin për Parandalimin dhe Reintegrimit e Personave të Radikalizuar. Për më shumë, Divizioni duhet të jetë më i hapur dhe inkurajues për profesionistët dhe organizatat e ndryshme dhe të sigurojë përfshirje më të gjerë të tyre në procesin e rehabilitimit dhe ri-integrimit;
2. Ministria e Arsimit në bashkëpunim me institucionet vendore duhet të aplikojë një qasje më proaktive në përpjekjet për ri-integrim dhe rehabilitim, dhe të hartojë një plan gjithëpërfshirës për integrimin e plotë të fëmijëve të riatdhesuar në shkollat publike, duke shmangur krijimin e klasave speciale vetëm për këtë kategori;
3. Qeveria e Kosovës duhet të hartojë dhe të zbatojë një strategji komunikimi që targeton komunitetet lokale, në mënyrë që të informojë në mënyrë aktive komunitetin në lidhje me procesin e ri-integrimit dhe rehabilitimit, e përmes komunikimit dhe ngritjes së vetëdijes të

rrisë gatishmërinë e komunitetit për të pranuar të kthyerit;

4. Meqenëse programet dhe politikat e ri-integrimit dhe rehabilitimit janë relativisht të reja për Kosovën, Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me akademinë dhe OShC-të duhet të implementojnë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve dhe njohurive. Fokusi duhet të jetë te ngritja e kapaciteteve të nevojshme në Komuna për krijimin e programeve të ri-integrimit dhe rehabilitimit, si dhe për shkëmbimin e njohurive dhe kapaciteteve me akterët e tjerë lokalë si: Këshillat Lokalë të Sigurisë, punonjësit socialë, mësuesit, OShC-të lokale, udhëheqësit e komuniteteve, etj.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës“Pjetër Bogdani”

323.28((496.51)(047)
314.151.5(=18:497.1)

Perteshi, Skender

Perceptimet e komunitetit mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe riatdhesimin e qytetarëve të Kosovës nga fushëbetejat e ISIS-it / Skender Perteshi & Shpat Balaj. - Prishtinë : QKSS, 2021. – 13 f. : 21 cm.

1. Balaj, Shpat

ISBN 978-9951-799-33-1

ISBN 978-9951-799-33-1



9 789951 799331